



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Strategjia e Teknologjisë së Informacionit për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës

Prishtinë, janar 2025

Hyrje

Strategjia e Teknologjisë së Informacionit (TI) përfshin vizionin dhe misionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për tri vitet e ardhshme 2025-2027. Përmes zbatimit të saj, ZKA synon t'i aplikojë praktikat më të mira dhe teknologjitë më të avancuara të informacionit në mënyrë që të sigurojmë një bazë të fortë për përmbushjen e objektivave të veta organizative.

Kjo strategji është dokument dinamik, i hartuar për të mbështetur ZKA-në në mjedisin që vazhdimisht po ndryshon në aspektin e TI-së, si nga brenda ZKA-së ashtu edhe jashtë saj. Puna e ZKA-së është e ndërlidhur me këto mjedise, prandaj ka nevojë t'i përshtatet ndryshimeve duke u pajisur me produkte/shërbime moderne të TI-së në mënyrë që të kryejë auditimet me efikasitetin më të lartë të mundshëm.

Ky dokument shërben si kornizë gjithëpërfshirëse për planifikimin, investimet, zhvillimin dhe menaxhimin e TI-së brenda ZKA. Strategjia synon të përcaktoj drejtimin strategjik të shërbimeve të TI-së në ZKA duke pasur parasysh se kufijtë e njohurive teknologjike po zgjerohen vazhdimisht, e si përgjigje ndaj këtij zgjerimi është thelbësore që ZKA të zhvillojë aftësi teknologjike për të përmbushur në mënyrë efektive detyrimet e veta institucionale.

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar në vend dhe Zyra Kombëtare e Auditimit është një trup i pavarur që ndihmon Auditorin e Përgjithshëm në përmbushjen e detyrave të tij/saj. Vizioni ynë është të jemi një institucion i besueshëm auditimi që përmirëson qeverisjen në sektorin publik, në interes të qytetarëve, dhe përmes auditimeve cilësore, forcon llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Përdorimi i teknologjiave të reja si cloud computing dhe analiza e të dhënave të mëdha (big data) pondikon në mënyrën si organizatat ndërveprojnë me teknologjinë. Ky zhvillim hap mundësi të reja për profesionistët e TI-së, por gjithashtu kërkon rishikim të planeve strategjike për të siguruar që ZKA është në përputhje me nevojat e reja të institucionit.

Përtej qëllimeve institucionale, faktorët e jashtëm ndikojnë në mënyrën se si e kryejmë punën tonë dhe mundësinë tonë për të zbatuar zgjidhje teknologjike. Kjo strategji konsideron mjediset e brendshme dhe të jashtme, shfrytëzon mundësitë potenciale dhe adreson pengesat për zbatimin e teknologjisë për të përmbushur nevojat në ndryshim të ZKA-së.

Strategjia e TI-së është krijuar për të mbështetur vizionin e ZKA-së për të qenë një institucion udhëheqës auditimi që kontribuon në llogaridhënien dhe transparencën e sektorit publik në Kosovë.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	3
1. Vizioni i TI-së.....	7
2. Misioni i TI-së	7
3. Mjedi i veprimit të Teknologjisë së Informacionit në ZKA.....	8
4. Parimet udhëzuese të TI-së në ZKA.....	10
5. Objektivat e TI-së	11
5.1.Infrastrukturë Moderne të TI-së.....	11
5.2.Teknologjitë Digjitale për Përmirësimin e Biznesit.....	12
5.3.Përdorimi i teknologjive të reja - Analiza e të Dhënave dhe Inteligjenca Artificiale	13
5.4.Qeverisja e TI-së.....	13
5.5.Mësimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm	14
6. Analiza SWOT	15
7. Zbatimi dhe monitorimi	17
8. Financimi dhe burimet	17
9. Rishikimi.....	17

1. Vizioni i TI-së

Një mjedis efektiv, i sigurt, modern dhe i besueshëm i TI-së, që mundëson punën si nga brenda ashtu edhe nga jashtë ZKA-së.

2. Misioni i TI-së

Të sigurojmë dhe mirëmbajmë një infrastrukturë të sigurt dhe moderne të TI-së duke përdorur zgjidhje inovative për të rritur efikasitetin e punës.

3. Mjedisi i veprimit të Teknologjisë së Informacionit në ZKA

Zyra Kombëtare e Auditimit ka sistem Informativ të pavarur. Në posedim ka serverë dhe ka Domain Controller (me domenin e vet) i cili administrohen nga stafi i TI-së. Departamenti i Teknologjisë Informative kryen të gjitha shërbimet e nevojshme për punë të TI-së në ZKA.

Sistemi i informacionit të ZKA-së përfshin këto kategori të shërbimeve:

- menaxhimin e përdoruesve dhe caktimin e nivelit të qasjes në sistem (Active Directorium)
- si email dhe VOIP (Email server dhe VOIP server)
- ruajtje dhe menaxhim e të dhënave (File Server dhe backup server)
- menaxhimin e bazave të të dhënave(SQL server dhe IIS server)
- siguri, mbrojtje me firewall, zbulim dhe parandalim i ndërhyrjeve, VPN për qasje nga distanca (Fortigate Firewall)
- monitorim të rrjetit dhe printim (Windows log dhe Print Server)
- lidhje me Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave (SIMFK) dhe Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB) të vendosur në rrjetin qeveritar.

Sistemin e Informacionit të ZKA-së përfshijnë kategori të ndryshme të të dhënave si:

- Të dhëna të përdoruesve që përfshijnë edhe të dhënat që krijohen dhe menaxhohen nga përdoruesit e sistemit;
- Dokumente të ndryshme dhe emaila;

- Të dhëna të aplikacionit SITA që përfshinë të dhënat që krijohen nga aplikacioni për menaxhimin e procesit të Auditimit;
- Të dhëna të sistemit apo të dhënat që gjenerohen nga vet sistemi si statistika të përdorimit të sistemit dhe regjistra të konfigurimit;
- Të dhënat e planifikimit të Auditimit ku përfshihen objektivat e Auditimit si dhe anëtarët e ekipit dhe rolet e tyre;
- Të dhënat e ekzekutimit të Auditimit ku përfshihen procedurat e Auditimit, gjetjet edhe provat;
- Të dhënat e raportimit të Auditimit ku përfshihen raportimi i rezultateve të Auditimit, raporti i Auditimit dhe çdo rekomandim;
- Të dhënat në bazat e të dhënave dhe shënimet nga Thesari dhe Payrolli që merren nga institucionet përkatëse;
- Të dhënat e sigurisë si listat e kontrollit të qasjes dhe sinjalizimet e sigurisë dhe
- Të dhëna të tjera në formë të imazheve dhe videove.

Ligji për shoqërinë e informacionit¹ përcakton funksionet dhe përgjegjësitë në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) të ASHI-së.

ASHI propozon dhe koordinon të gjitha politikat që ndërliken me teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në institucionet e Republikës së Kosovës.

Pavarësisht se jemi Institucion i pavarur kushtetues dhe kemi një autonomi në zhvillimin e aktiviteteve të TI-së prapë jemi të varur në disa aspekte nga ASHI.

- Duhet ta informojmë ASHI dhe të marrin pëlqimin lidhur me projektet e planifikuara për t'u investuar në fushën e TIK;
- Jemi të varur nga ASHI për sigurimin e licencave të Microsoft-it.

1 Ligji Nr. 04/L-145

4. Parimet udhëzuese të TI-së në ZKA

Këto parime e ndihmojnë dhe vendosin drejtimin e zhvillimit dhe zbatimit të TI-së brenda ZKA-së, si dhe sigurojnë që TI mbështet qëllimet dhe vlerat e ZKA në mënyrë efektive.

Siguria: Sigurimi që të gjitha sistemet e TI-së dhe të dhënat janë të sigurta, duke mbrojtur informacionin e ndjeshëm nga qasja e pa-autorizuar.

Inovacioni: Përdorimi i teknologjive të reja dhe përshtatja ndaj ndryshimeve në mjedisin e TI-së.

Efikasiteti: Përmirësimi i proceseve dhe rrjedhave të punës përmes TI-së për të rritur produktivitetin.

Transparenca: Përdorimi i TI-së për të ofruar qasje në informacion të qartë dhe të saktë.

Bashkëpunimi: Lehtësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit përmes platformave të TI-së.

Qëndrueshmëria: Zbatimi i zgjidhjeve të qëndrueshme TI-së që kontribuojnë në qëllimet afatgjata të ZKA-së.

5. Objektivat e TI-së

5.1. Infrastrukturë Moderne të TI-së

Të zhvillojmë dhe mirëmbajmë një infrastrukturë të TI-së të fuqishme, të shkallëzueshme dhe të sigurt që plotëson nevojat në ndryshim të ZKA-së.

Kjo përfshin pëmisime në:

- **Harduerin:** Serverë, laptop, monitor dhe pajisje të tjera.
- **Softuerin:** Sisteme operative dhe aplikacione të përditësuara.
- **Rrjetin:** Pajisje të shpejta, të sigurta dhe të besueshme.

Një infrastrukturë moderne mundëson menaxhim më të mirë të të dhënave, siguri të përmirësuar, produktivitet të rritur dhe mundësinë për të adoptuar teknologjitë e reja si Cloud computing dhe Inteligjencë Artificiale. Gjithashtu ne do të mundohemi që sistemet tona të jenë dinamike dhe të pavarura nga vendndodhja.

- Për çdo vit do të bëhet vlerësimi i komponentëve aktuale të harduerit, softuerit dhe rrjetit
- Identifikohen sistemet e vjetruara dhe pajisjet që kanë nevojë për përmisim.
- Vendoset cikli i rinovimit të harduerit
- Rifreskimi i pajisjeve të rrjetit për shpejtësi më të lartë
- Përmisohet mbulimi dhe performanca e Wi-fi-së
- Firewall-i i gjeneratës së re azhurnohet rregullisht dhe konfigurohet me politika të reja.
- Përdorimi i teknologjive cloud kudo që është e mundur.
- Përdorimi i hapësirave për ruajtjen e shënimeve në cloud si Microsoft One Drive

- Zbatimi i platformave -softueri si shërbim- si MS 365 për të gjithë stafin.
- Zbatimi i sistemeve për menaxhim të pajisjeve,
- Përmisimi i Infrastrukturës në sallat e mbledhjeve (ekranet, projektorët, sistemet e konferencave dhe ato të përkthimit)

5.2. Teknologjitë Digjitale për Përmirësimin e Biznesit

Të shfrytëzojmë mjetet dhe teknologjitë digjitale për të përmirësuar proceset e biznesit dhe bashkëpunimin, duke rritur efikasitetin dhe efektivitetin e përgjithshëm. Përdorimi i platformës SAAS (softueri si shërbim) MS 365 E3.

Përdorimi i MS 365 ka për qëllim që të përmisoj bashkëpunimin dhe komunikimin. Forcoj sigurinë dhe të lehtësoj menaxhimin e dokumenteve dhe proceseve të punës. Gjithashtu të siguroj edhe fleksibilitet në infrastrukturën e TI.

Qëllimi jonë është që të krijojmë një mjedis pune që është i pavarur nga vendi ku ndodhemi. Ku koleget mund të punojnë në mënyrë sigurtë dhe me efikasitet.

- Realizohet plani i implementimit ku përcaktohen fazat dhe afatet e implementimit.
- Bëhen konfigurimet e nevojshme si të Azure Active Directory, Exchange online për email, Teams për komunikim dhe bashkëpunim dhe Sharepoint për menaxhim të dokumenteve.
- Konfigurohet Siguria e cila përfshinë parandalimin e humbjes së të dhënave, dhe mbrojtjen e informacionit.
- Me këtë rast sigurohet bashkëpunim me i mire dhe rritje e produktivitetit në punë.

5.3. Përdorimi i teknologjive të reja - Analiza e të Dhënave dhe Inteligjenca Artificiale

Të zbatohet zgjidhje të avancuara të analizës së të dhënave për të nxjerrë njohuri në bazë të të cilave edhe përmissohet cilësia e raportimeve.

- Hulumtohet tregu në mënyrë që të sigurojmë aplikacione për nevoja të auditorëve të TI-së
- Të përcaktojmë burimet e të dhënave dhe mënyrat se si do ti marrim ato.
- Sigurohen licencat për Power BI dhe realizohen trajnimet për përdorimin e aplikacionit
- Realizohet pastrimi i të dhënave dhe zgjidhen metodat për vizualizimin e tyre.
- Mjetet e Inteligjencës Artificiale mund të përdoren për analiza, për përpilimin e teksteve, për realizim të përmbledhjeve për nevoja të asistimit në punë.
- Trajnohet stafi për mënyrën e përdorimit të AI, dhe përdorimin e sigurt të AI.
- Krijimi i kontrolleve dhe mekanizmave mbrojtës gjatë përdorimit të AI në ZKA.

5.4. Qeverisja e TI-së

Të krijojmë dhe mirëmbajmë qeverisjen e TI-së për të siguruar përputhjen e investimeve të TI-se me qëllimet organizative, përputhshmërinë me rregulloret dhe shfrytëzimin optimal të burimeve TI.

- Ndërtojmë raporte dhe bashkëpunime të mira me sektorin privat të cilin e përdorim edhe si burim informacioni dhe ndihmues në realizimin e projekteve të reja të TI,
- Krijim grupin punues të TI-se i cili lehtëson adoptimin e projekteve dhe teknologjive të reja
- Përgatitja e procedurave dhe politikave të reja
- Rishikimi i procedurave dhe politikave të TI-se

5.5. Mësimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm

Suksesi i një organizate varet nga njerëzit e saj, për atë është shumë e rëndësishme që aftësitë e punonjësve të zhvillohen për të përmbushur kërkesat e biznesit. Të mësuarit e vazhdueshëm është një mënyrë për ta bërë këtë.

- Inkurajimi i mësimi dhe zhvillimit
- Pjesëmarrja në forume, projekte të përbashkëta dhe shpërndarja e praktikave të mira
- Anëtarësimi në platforma si Cybrary, Coursera, LinkedIn Learning, Udemy për përcjelljen e trajnimeve online.

6. Analiza SWOT

Përparësitë	Dobësitë
Infrastrukturë e mire e TI- Sisteme të pavarura ekzistuese me shërbime gjithëpërfshirëse si menaxhimi i përdoruesve, komunikimi, ruajtja e të dhënave dhe siguria. Drejtim i qartë strategjik në përputhje me planin e përgjithshëm - Mision, vizion dhe parime udhëzuese të IT-së të përcaktuara mirë. Adoptim i teknologjive të avancuara si cloud computing dhe platformave SaaS si Microsoft 365 E3. Fokus në sigurinë kibernetike - Përqendrim i fortë në sigurinë kibernetike me konfigurime të avancuara të sigurisë, firewall dhe VPNë Përputhshmëri me rregulloret kombëtare - Përshtatje me rregulloret kombëtare dhe koordinim me Agjencinë për Shoqërinë e Informacionit.	Varësi nga kompanitë e jashtme për disa shërbime të TI-se Nevoja e vazhdueshme për azhurnimin e njohurive të stafit, rreziku i mungesës së ekspertizës në teknologjitë e avancuara Kompleksitet në zbatimin e sistemeve të reja. Rreziku i ndërprerjes gjatë kalimit në teknologjitë e reja Kufizime të mundshme buxhetore

Mundësitë	Kërcënimet
Përmirësim i bashkëpunimit dhe efikasitetit përmes mjeteve digjitale të bazuara ne cloud si Microsoft 365 E3	Diversiteti i Përdoruesve: Nevoja të ndryshme, pritshmëri dhe aftësi teknike të ndryshme midis përdoruesve.
Shfrytëzim i teknologjive të reja si AI për punë më të mirë potenciali për të zbatuar zgjidhje inovative	Varësia nga ASHI: Varësia nga ASHI për licencat dhe aprovim të projekteve të TI.
Kontribut në rritjen e transparencës në sektorin publik	Kufizimet e Investimeve në Infrastrukturë: Operimi në një ndërtesë me qira, që kufizon investimet afatgjata.
Formim të partneriteteve me institucione të tjera për të shfrytëzuar njohuritë dhe ekspertizën	Rritje e kërcënimeve kibernetike dhe nevoja për monitorim dhe përditësime të vazhdueshme të protokolleve të sigurisë
	Zhvlerësimi i shpejtë i teknologjisë mund të bëjë që sistemet e reja të bëhen të vjetruara shpejt nëse nuk përditësohen
	Kontrata kornize të cilat nganjëherë nuk i përmbushin kërkesat.

7. Zbatimi dhe monitorimi

Zbatimi i Strategjisë së TIK-ut do të udhëhiqet nga ZKA IT në bashkëpunim të ngushtë me Departamentet tjera në ZKA. Për të arritur objektivat e saj, ZKA-ja ka hartuar planin e veprimit për periudhën 2023-2026. Strategjia e TI do të inkorporohen në planet vjetore të punës së Departamentit të TI-së. Strategjia gjithashtu do të monitorohet në baza vjetore dhe do të raportohet të AP.

8. Financimi dhe burimet

Strategjia e TI-së ka nevojë për financim adekuat. Financimi shtesë dhe burimet teknike janë thelbësore për të përmirësuar vazhdimisht infrastrukturën, sistemet dhe mjetet e TI-së në mbështetje të transformimit dixhital të ZKA. Burimet e kërkuara përfshijnë sistemet dhe mjetet, dhe mbështetjen e fuqisë punëtore.

ZKA do të ketë nevojë për aftësi dhe trajnim të vazhdueshëm si dhe mjedisin e nevojshëm për të adoptuar procese dhe praktika të reja të cilat do të mbështesin një TI më të avancuar.

9. Rishikimi

Kjo Strategji e TI do të rishikohet çdo vit dhe do të modifikohet për të pasqyruar progresin në zbatim, duke përfshirë ndryshimet në mjedisin operativ për të siguruar që ajo të mbetet e rëndësishme dhe efektive.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës

